



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:191207
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05852167

K.Dh.Shk II.nr.868/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Francika Zhitija Ymeri në çështjen përmbare të “DLD Group” SH.P.K., me NUI: 810841636, me seli në rr. “Perandori Justinian” nr.25, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Hoti, avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në rr. “UÇK” nr. 2, në Prishtinë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1435/23 të datës 30.11.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “DLD Group” SH.P.K me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1435/23 të datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1435/23 të datës 30.11.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, të ushtruar kundër Urdhrit për

Përmbarrim P.nr.613/23 të dt. 24.08.2023 të Përmbarruesit Privat Irfan Kerçagu, dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (me pretendime sikurse në ankesë), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1435/23 të datës 30.11.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “DLD Group” SH.P.K., me datën 24.08.2023 ka paraqitur propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 2022/0035 të datës 15.12.2022 ka lejuar Urdhërin Përmbarrimor P.nr.613/23, të datës 24.08.2023, me të cilin është urdhëruar që të ia paguaj kreditorit në tërësi borxhin në shumë të përgjithshme prej 1,833.33 €, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe bartjen në llogarinë bankare të organit përmbarrues, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, bllokimin e rentave dhe qirave të debitorit, deri në vlerën e borxhit

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor, duke theksuar ndër të tjerash se provat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarrim nuk janë dokumente të besueshme, për shkak se kreditori ka bashkangjitur vetëm faturën kopje e cila nuk mund të jetë objekt përmbarrimi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet

prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të abrogohet urdhri për përmbarim. Kreditori në përgjigjen në prapësimin të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt, janë të nënshkruara, kanë vlerën dhe datën e lëshimit njëkohësisht vërehet se debitori nuk e përmbush detyrimin që rrjedh nga ky dokument. Më tutje ka shtuar se provat e paraqitura nga debitori nuk dëshmojnë asgjë dhe kanë për qëllim zvarritjen e procedurës përmbarimore. Gjykatës i ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor dhe të detyrohet debitori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 104.00 €.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret konkret Fatura Nr. 2022/0035 të datës 15.12.2022 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Duke shtuar se sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par 1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, andaj fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret fatura e lartcekur nuk janë në origjinal apo kopje e vërtetuar ashtu siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së. Ka shtuar se propozimi mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinal apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilës është iniciuar procedura përmbarimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata

Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, e që në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura e lartcekur nuk janë në origjinal apo kopje e vërtetuar, kështu që në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.164/23 i datës 23.06.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarrim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së,

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson pretendimet ankimore por ishin pa ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarrimore. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.868/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,
Francika Zhitija Ymeri